



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 13.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj, Agim Aliu dhe Doruntinë Maloku.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Fatmir Limaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Alma Tafarshiku, EULEX; Florina Merovci, ZPRK; Alban Rexha dhe Kaltrina Ahmeti, GLPS; Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office; Liridona Xhemajli, RTV21; Valmira Vranovci, Rrokum TV; Petrit Hysaj, OSBE; Baki Gimolli, MD dhe Gentiana Dushi, praktikante.

Nga Staf i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mjekësinë Ligjore;
4. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Kryesuesja, tha se janë plotësuar kushtet për procedim të projektligjit, pasi ka kaluar afati i paraparë me rregullore, që kur iu është shpërndarë deputetëve. Po ashtu, në aspektin formal, projektligji ka shkresat përcjellëse, dhe si i tillë, nuk ka pengesa për procedim të mëtejshëm. Ftoi anëtarët që nëse kanë ndonjë vërejtje për projektligjin, t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mjekësinë Ligjore

Kryesuesja, tha se janë plotësuar kushtet për procedim të projektligjit, pasi ka kaluar afati i paraparë me rregullore, që kur iu është shpërndarë deputetëve, por për dallim nga projektligji paraprak, tek ky projektligj, në deklaratën e Ministrisë së Financave është vlerësuar se projektligji do të prodhojë kosto shtesë buxhetore. Mirëpo, në këtë fazë, vlerësoi se mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim të parë dhe pastaj në grupet punuese do të shohin se çfarë mund të ndryshohet.

Armend Zemaj, tha se është një projektligj i rëndësishëm. Dihet që në të kaluarën ka pasur kompetenca të ndërkombëtarëve dhe bartja e këtyre përgjegjësisë tek vendorët, sigurisht që do të ketë kosto buxhetore. Në këtë fazë vlerësoi se mund të procedohet për shqyrtim në parim, kurse në fazën e amendamentimit, mund të japë kontribut edhe Komisioni për Shëndetësi, kurse aspektin financiar do ta vlerësojë Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Agim Aliu, tha se projektligji duhet të përkrahet, për arsyet që janë dhënë edhe në memorandum shpjegues, por edhe duke pasur parasysh faktin që duhet të ketë avancim nga një departament në agjenci. Po ashtu, duhet të kemi parasysh rëndësinë që ka si departament i mjekësisë ligjore dhe nga problematika që ka trajtuar dhe ndjeshmërinë që kemi kaluar si shtet. Më tutje, tha se në faza tjera duhet të kemi edhe mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe

Financa, për ta funksionalizuar me kapacitetet e duhura, veçmas tani kur kemi edhe kalim të kompetencave tek vendorët.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji për Mjekësinë Ligjore.

4. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesja, tha se tanimë e keni të njohur ecurinë e këtij projektligji. Janë mbajtur disa takime dhe tanimë ka kaluar edhe në parim, në Kuvend. Propozoi që për amendamentim të projektligjit, të formohet një grup punues. Meqë ka pasur një grup që ka punuar më herët, propozoi të jetë përbërja e njëjtë, përveç kryesuesit që duhet të vendoset, pra Agim Ademaj, Agim Aliu dhe Danush Ademi. Meqë nuk kemi sot përfaqësues nga opozita në këtë takim, atëherë ata mund të marrin pjesë në takimet e grupit punues, nëse shprehin gatishmëri.

Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në përbërje:

Agim Aliu - kryesues,
Agim Ademaj - anëtar, dhe
Danush Ademi - anëtar.

5. Të ndryshme

Kryesuesja ngriti shqetësimin e saj lidhur emërimin e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike nga Ministria e Drejtësisë.

Armend Zemaj, tha se tashmë është pikë e rendit të ditës në seancë plenare. Pra, edhe nëse shkon në formën që është propozuar, nuk është ndonjë problem, pasi që si Komision, e kanë vlerësuar bazën ligjore. Më tutje, foli për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahasim të Pronave, që duhet të përshpejtohet dhe kërkoi që takimi i radhës së grupit punues, të mbahet më 19.10.2015, në orën 10:00. Po ashtu, foli edhe për Projektligjin për Kuvendin, duke thënë se tanimë e kanë marrë opinionin e Qeverisë dhe duhet të takohen si

Nënkomision, që ta shqyrtojnë dhe të shohin se si do ta procedojnë. Në këtë kontekst, tha se ngjarjet e kaluara në Kuvend, por edhe ato të fundit, më së miri flasin për nevojën se duhet pasur një ligj për Kuvendin.

Kryesuesja, duke folur për agjendën e radhës të Komisionit, foli edhe për nismën e Komisionit për hartimin e ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, të cilin e kryeson. Po ashtu, tha se do të caktohet data për mbajtjen e takimit me aktorët e interesuar dhe do të vendoset se çka mund të bëhet në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,
Selvi Halimi
